



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1153 prot.

Tiranë, më 10.09.2024

Lënda: Dërgim Informacioni

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Rr. "Bajram Curri", Tiranë

Ju informojmë se, në Institutin e Nxënësve që Nuk Shikojnë, Bashkia Tiranë, në zbatim të Urdhrit Nr. 1029, datë 28.03.2024, "Për miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë", Urdhërit Nr. 52, datë 19.01.2024 "Për miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës", "Kodi i Sjelljes dhe Etikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve" Nr. 1349/5 prot, datë 12.12.2023, Urdhrit të Ministrit të Arsimit Nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", shpallet **1 (një)** vend i lirë pune për **Operator Braille** në Institutin e Nxënësve që Nuk Shikojnë, (Paga sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar).

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale, në momentin që aplikanti shpallet fitues:

1. CV
2. Vërtetim banimi.
3. Çertifikatë personale dhe familjare
4. Dëftesë/ Diplomë + listë notash (kopje të noterizuara)
5. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)
6. Librezë pune origjinale
7. Raport mjeko – ligjor
8. Dëshmi penaliteti (deri në momentin e paisjes me dëshmi penaliteti, fotokopje të kuponit të aplikimit në postë)
9. 2 fotografi

Disa nga detyrat që duhet të kryejë një Operator Braille në INNSH janë:

1. Operatori i kodit Braille zotëron kodin Braille për gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera të përdorura në materialet didaktike në INNSH.
2. Operatori i kodit Braille transkripton tekstet mësimore, jashtë mësimore dhe çdo material tjetër që i paraqitet si kërkesë nga eprori, në shkrimin Braille, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të tjera të nevojshme.
3. Operatori i kodit Braille ka për detyrë të korrektojë, redaktojë e printojë (në printer Braille) tekstet mësimore.
4. Sipas kërkesave të mësuesve dhe ndihmës mësuesve, të miratuara nga drejtuesi i institucionit, operatori i kodit Braille duhet të prodhojë mjete didaktike përkatës në termoform.
5. Në bashkëpunim me punonjës të tjerë përgjegjës për shtypjen e librave, ai duhet të prodhojë librat duke përdorur pajisjet për lidhjen e tyre.
6. Operatori i kodit Braille, duhet të njohë të gjitha pajisjet e instaluara në shtypshkronjën e institucionit, si edhe mjete të tjera të teknologjisë asistive jashtë shtypshkronjës, të lidhura me punën e tij.
7. Në përputhje me standardet e pranuar botërisht, operatori i kodit Braille duhet të njohë, të instalojë, konfigurojë dhe të përditësojë programet kompjuterike për prodhimin e librave në Braille (Duxbyry Braille Translater DBT dhe programe të tjera të transkriptimit të kodit Braille).
8. Operatori i kodit Braille ka për detyrë hulumtimin, zhvillimin dhe përdorimin e programeve që prodhojnë librat me figura në gjuhën Braille (Tactile VIEË V2.5 dhe versionet pasardhëse).
9. Operatori i kodit Braille njeh dhe merr përsipër të përditësojë njohuritë, rreth konfigurimeve të printerave Braille në shtypshkronjë. Gjithashtu, ai zotëron aftësinë për të aplikuar ndryshime të nevojshme në konfigurimet e pajisjeve në fjalë.
10. Operatori i kodit Braille hulumton në internet për të reja të kodit Braille, dhe përvetëson ç'ka është e nevojshme për mbarrëvajtjen e punës në institucion. Zhvillimet dhe përditësimet e gjetura aprovohen dhe miratohen me shkrim nga drejtuesi.
11. Operatori i kodit Braille i nënshtrohet testimeve të ndryshme mbi njohuritë dhe përditësimet në kodin Braille.
12. Duke u udhëhequr nga përkujdesi, dhe respekti për punën me pajisjet speciale me vlerë disa mijëra euro, operatori i kodit Braille duhet të ruajë dhe administrojë me rigorozi ambientet dhe mjetet e shtypshkronjës.

Për sa më sipër sqarojmë se:

Për pozicionin e punës si Operator i teksteve Braille në INNSH, duhen plotësuar kriteret e mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë Informatikë (Master).
- Të ketë eksperiencë pune të mëparshme.

Afati për dërgimin e CV- ve në email: femijet@tirana.al është deri më datë 19.09.2024.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

